



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

---

Numri i lëndës: 2021:205664

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05701660

**P.nr.69/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm,** Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.Sh, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par. 1 dhe 3 nën par.3.1 si dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1274/21 të datës 02.03.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **13.03.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të akuzuarit V.Sh, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 11.04.2024, përpiloi, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**V.Sh,** nga i ati G. dhe e ëma S. e gjinisë P., i lindur me ... në Istog, me vendbanim në fshatin M. rr. “Dukagjini” nr.19 Komuna I., i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, nuk ka të kryer shkollë, ka njohuri sa për të shkruar emrin e tij, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, me numër personal ..., egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 10.07.2021, rreth orës 05:50 minuta, në Istog, pikërisht në vendin e quajtur “Bjeshkët e Moknës”, pjesë e parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, me qëllim të vjedhjes, në bashkëkryerjes, prej 17 copë drunjë të llojit molik, me vëllim të përgjithshëm 19.09 m<sup>3</sup>, në atë mënyrë që të pandehurit pasi fillimisht i prej 17 drunjët e lartcekur, sasinë prej 1.60 m, i ngarkojnë në automjetin Peugeot export 03-326-EL, ku gjatë bartjes së tyre, i pandehuri B.M haset nga patrulla e stacionit kufitar SMK- Vitomericë, si dhe nga zyrtarët e AKP-së Istog, të cilët masën drusore e sekuestrojnë.

- me çka ka kryer veprën penale **vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par. 1 dhe 3 nënpar.3.1 si dhe nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69 të KPRK-së dhe nenin 242, 364 dhe 369 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqipton:

## **DËNIM ME BURGIM DHE GJOBË**

- I. Ashtu që, të pandehurit **V.Sh**, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, dhe dënimi me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro, *të cilat dënime do të jenë të kushtëzuara, nuk do të ekzekutohen* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
  - **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë.
- II. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguaj **njëzet (20) euro** për paushallin gjyqësor ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. **Pala e dëmtuar:** Komuna Istog, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt juridiko civil.

### A r s y e t i m

#### Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1274/21 të datës 02.03.2022, kundër të pandehurve B.M dhe V.Sh për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 e lidhur me par.3 nën par.3.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 13.03.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj dhe i pandehuri V.Sh.

Gjykata për shkak të mos prezencës së të pandehurit B.M, i cili cilët nuk ka prezantuar as ne seancat e mëparshme të caktuara në këtë çështje penale ku sipas raportit të policisë së datës 24.02.2024, rezulton se gjendet në Gjermani, dhe për shkak të efikasitetit të procedurës, ka marrë mendimin e palëve prezent lidhur me veçimin e kësaj procedure penale ne raport me këtë të pandehur, ku pasi ka dëgjuar palët prezentë dhe pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lënës në pajtim me nenin 35 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka bërë veçimin e

procedurës penale ne raport më të pandehurin B.M e cila lëndë e veçuar ndaj tij do te evidentohet me numër të ri të lëndës, ndërsa sa i përket te pandehurit V.Sh, është vendosur që procedura do te vazhdohet me numrin ekzistues të lëndës.

Seanca e shqyrtimi fillestar ka vazhduar ndaj te pandehurit V.Sh, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e kanë kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

**I pandehuri V.Sh,** ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë , pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime, dhe i premtton gjykatës se në të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do te kryej vepra penale.

**Prokurori i Shtetit,** lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë te bërë nga ana e te akuzuarit, meqenëse një pranim i tillë u bë në mënyrë vullnetare dhe gjen mbështetje ne provat qe gjenden ne shkresa te lëndës .

#### Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimit të lartcekur edhe nga prokurori i shtetit si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, 2, nën par. 2.1, 2.2, dhe 2.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për te cilën është akuzuar.

#### Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata duke vepruar konform nenit 359 par.2 të KPP-së, sa i përket veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par. 3 nën par.3.1 si dhe nenin 31 te KPRK-së, për të cilat është akuzuar i pandehuri sipas aktakuzës të lartcekur, dhe të gjitha provave qe gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se i pandehuri me veprimet inkriminuese te ndermarrura i ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par. 1 dhe 3 nën par.3.1 si dhe nenin 31. Prandaj ky ndryshim i cilësimit juridik të veprimeve inkriminuese te të pandehurit, duke i'a shtuar nenit 349 par.2 dhe 3 edhe formën themelore te kryerjes se kësaj vepre penale “par.1”, bëhet i domosdoshëm, ngase një ri – cilësim i tillë është edhe konform përshkrimit faktik të kësaj vepre penale dhe nuk e ndryshon as sanksionin penal, rrjedhimisht mbi këto fakte dhe dispozita ligjore gjykata bëri rikualifikimin e kësaj vepre penale, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t’a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti

është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve ligjore, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### *Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit*

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësisë dhe rrethanat personale se është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe se është mbajtës i familjes. Ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se i njëjti ka qenë i dënuar edhe me parë nga gjykata me aktgjykim të formës së prerë në çështjen penale të evidentuar me numër të SMIL-it: 2021:290358. Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e këtui pandehurit, i cili do ta kuptojë rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepra penale, si dhe do të ndikojë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj si dhe dënimi me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepra penale.

Gjykata, të pandehurit me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepra tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

#### *Shpenzimet e procedurës*

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës penale, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e

Viktimave të Krimit, i obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

*Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike*

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Procesmbajtësja**  
**Hale Ahmetaj**

**GJYQTARI**  
**Petrit Nrecaj**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*